

Akt Themelimi i Shoqërisë Tregtare "Digit Alb" shpk.

Sot më datë 24 Mars 2004 në Tiranë themeluesit:

1. Z. DRITAN HOXHA, i biri i Fiqiriut, i lindur në 1968, banues ne Tiranë.
2. Z. PETRAQ SHOMO, i biri i Dhimitraqit, i lindur në 1963, lindur dhe banues ne Tiranë,
3. Z. ARBEN TAIPi, i biri i Ahmetit, i lindur në 1965, lindur dhe banues ne Tiranë,
4. Z. ENKELEJDI JOTI, i biri i Kristaqit, i lindur në 1969, lindur dhe banues në Tiranë,
5. Z. ALBAN JAHO, i biri i Nuriut, i lindur në 1969.
6. Z. Eduard Poda, i biri i Shpetimit, lindur ne 1968

Bazuar në nenet 37 deri 73 të ligjit nr. 7638 dt.19 Nëntor 1992 "Për shoqëritë tregëtare" si ortakë kanë vendosur të kryejnë veprimtari private dhe sanksionojnë më poshtë krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve që vijojnë:

Neni 1

¹ Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Digit Alb" sh.pk.

² Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- a. Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim-marrës.
- b. Administratori i Përgjithshëm, për përfaqsimin e shoqërisë në mardhëniet me të tretët dhe drejtimin e politikave financiare të saj.

Neni 2

"Digit Alb" shpk ka për objekt të veprimtarisë

- a. Ndërtimin dhe tregtimin e sistemeve të telekomunikacioneve dhe transmetimeve televizive,
- b. Tregtimin e aparaturave për sisteme të transmetimit dhe marrjes së valëve televizive,
- c. Prodhim, transmetim dhe shitje ne menyre digitale te produkteve dhe sherbimeve audio e video,

Neni 3

Selia ligjore dhe administrative e "Digit Alb" shpk ndodhet në Republikën e Shqipërisë në qytetin e Tiranës, në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", Qendra Ndërkombëtare e Kulturës.

Neni 4

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie përbëhet nga 800'000 (tetëqind mijë) Euro të depozituara në Bankën Italo-Shqiptare për llogari të "Digit Alb" shpk. nga ortakët dhe kuotat e kapitalit themeltar do të ndahen si më poshtë:

1. Ortaku DRITAN HOXHA, i biri i Fiqiriut, i lindur në 1968, banues ne Tiranë, që ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 560'000 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) Euro, zotëron 70 % (shtatëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar.
2. Ortaku PETRAQ SHOMO, i biri i Dhimitraqit, i lindur në 1963, lindur dhe banues ne Tiranë, që ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 80'000 (tetëdhjetë mijë) Euro, zotëron 10 % (dhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar.
3. Ortaku ARBEN TAIPi, i biri i Ahmetit, i lindur në 1965, lindur dhe banues në Tiranë, që ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 80'000 (tetëdhjetë mijë) Euro, zotëron 10 % (dhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar.

4. Ortaku ENKELEJDI JOTI, i biri i Kristaqit, i lindur në 1969, lindur dhe banues në Tiranë, që ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 26,666 (njezet e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhjet e gjashte) Euro zotëron 3.33 % (tre pike tridhjetë e tre) të pjesëve të kapitalit themeltar.

5. Ortaku ALBAN JAHO, i biri i Nuriut, i lindur në 1969, banues në Tiranë, ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 26,666 (njezet e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhjet e gjashte) Euro, zotëron 3.33 % (tre pike tridhjetë e tre) të pjesëve të kapitalit themeltar.

6. Ortaku EDUARD PODA, i biri i Shpetimit, i lindur në 1968, banues në Tiranë, ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 26,666 (njezet e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhjet e gjashte) Euro, zotëron 3.33 % (tre pike tridhjetë e tre) të pjesëve të kapitalit themeltar.

Neni 5

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me dispozitat e këtij akti themelimi, të statutit të mirtuar nga Ansambleja themeluese, që i bashkangjitet aktit të themelimit, dhe në bazë të legjisllacionit shqiptar në fuqi.

Neni 6

Kohëzgjatja e shoqërisë kufizohet në një afat prej 25 (njëzet e pesë) vjetësh dhe mund të zgjatet me vendim të Ansamblesë të shoqërisë sipas shumices së cilësusur të parashikuar në statut.

Neni 7

Në përputhje me Nenin 36 të statutit të shoqërisë së sapoformuar themeluesit vendosin që për mandatin e parë 3 vjeçar shoqëria të ketë Administrator te Pergjithshem ortakun Dritan Hoxha.

Neni 8

Administratori i Pergjithshem gëzon të drejta të plota në mardhëniet e shoqërisë me të tretët dhe të punësuarit dhe për sa i përket administrimit të shoqërië, brenda kufijve të lejueshëm nga statuti i shoqërisë dhe nga legjisllacioni shqiptar në fuqi dhe nga vendimet e Ansamblesë.

Neni 9

Viti financiar fillon më 1 Janar të çdo viti dhe përfundon ditën e fundit të Dhjetorit të po atij viti, ndërsa për sa i përket aktivitetit mësimor shkolla do të funksionojë sipas vitit akademik.

Neni 10

Shpenzimet e nevojshme deri në themelimin e shoqërisë janë në ngarkim të shoqërisë, e cila me regjistrimin e saj i merr përsipër këto shpenzime si detyrime të saj.

ORTAKËT THEMELUES

DRIPTAN HOXHA
Dritan Hoxha

PETRAQ SHOMA
Petraq Shoma

ARBEN TAIPI
Arben Taip

EDUARD PODA
Eduard Pod

ENKELEJDI JOTI
Enkelejdi Joti

ALBAN JAHO
Alban Jaho

Statut i Shoqërisë Tregtare "Digit Alb" shpk.



KREU I

DISPOZITA THEMELORE

NENI 1

Bazuar në legjislacionin në fuqi, veçanërisht në ligjin, në ligjin nr. 7638 dt. 19 Nëntor 1992 "Për shoqëritë tregëtare", në ligjin nr. 7667 dt. 28 Janar 1993 "Për Regjistrin tregëtar dhe formalitetet që duhen rrespektuar nga shoqëritë tregëtare", në dispozitat e Kodit Civil si dhe në zakonet e mira tregëtare, sipas marrveshjes së ortakëve dhe aktit të themelimit të hartuar prej tyre, hartohet ky Statut për rregullimin normativ të funksionimit të një shoqërie tregëtare.

NENI 2

Shoqëria që do të ushtrojë veprimtarinë në bazë të këtij statuti do të jetë formës *shoqëri me përgjegjësi të kufizuar* dhe do të ushtrojë aktivitetin e saj në Republikën e Shqipërisë në bazë të regjistrimit në institucionet tatimore dhe në institucionet tregëtare shqiptare, si dhe jashtë saj në bazë të modaliteteve ligjore që kërkohen nga shteti ku do të ushtrojë veprimtarinë.

NENI 3

Për efekt të regjistrimit dhe të gjitha modaliteteve të tjera ligjore shoqëria do të quhet "*Digit Alb*" shpk.

NENI 4

¹ Shoqëria "Digit Alb" shpk. do të ushtrojë aktivitetin e saj tregëtar për një periudhë 25 (njëzet e pesë) vjeçare, që fillon ditën e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar dhe përfundon ditën e nesërme të datës së regjistrimit pas 25 (njëzet e pesë) vjetësh aktivitet.

² Nëpërmjet miratimit me vendim të zotëruesve të 3/4 të kapitalit themeltar, në Ansamblenë e jashtëzakonëshme të Ortakëve kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë mund të zgjatet tej afatit të parashikuar në paragrafin e mësipërm.

³ Nëpërmjet vendimit të Ansamblesë së jashtëzakonëshme me një shumicë prej të paktën 8/9^{sh} të zotëruesve të kapitalit themeltar, kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë mund të apo shkurtohet ose aktiviteti i shoqërisë mund të ndërpritet tërësisht dhe menjëherë.

NENI 5

¹ Shoqëria "Digit Alb" shpk do të jetë një shoqëri tregëtare me kapital tërësisht shqiptar dhe objekt të ushtrimit aktivitetit të saj:

a. Ndërtimin dhe tregtimin e sistemeve të telekomunikacioneve dhe transmetimeve televizive,

b. Tregtimin e aparaturave për sisteme të transmetimit dhe marrjes së valëve televizive,

c. Prodhim, transmetim dhe shitje në menyre digitale të produkteve dhe shërbimeve audio e video,

² Nëpërmjet miratimit me vendim të zotëruesve të një shumice prej 8/9^{sh} të zotëruesve të kapitalit themeltar, në mbledhjen e Ansamblesë së jashtëzakonëshme të Ortakëve, brenda kufijve e konform modaliteteve të lejuar nga legjislacioni, mund të bëhet ndryshimi, shtimi ose pakësimi i aktiviteteve që përbëjnë objektin e shoqërisë.

NENI 6

¹ Nëpërmjet miratimit me vendim të zotëruesve të shumicës së kapitalit themeltar në mbledhjen e Ansamblesë së jashtëzakonëshme të Ortakëve shoqëria mund të hapë filiale të saj brenda ose jashtë Shqipërisë.

² Dispozitat e këtij Statuti do të kenë fuqinë e normave themeltare për rregullimin normativ të aktivitetit të këtyre filialeve.

NENI 7

¹ Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 800'000 (tetëqind mijë) Euro të depozituara në llogari të shoqërisë në Bankën Italo Shqiptare

² Nëpërmjet miratimit me vendim të zotëruesve të të paktën 8/9^{tave} të kapitalit themeltar në mbledhjen e Ansamblesë së jashtëzakonëshme të Ortakëve shoqëria mund të zvogëlojë ose zmadhojë kapitalin e saj themeltar në përputhje me nenet 62 deri 64 të ligjit 7638 dt. 19 Nëntor 1992 "Për shoqëritë tregëtare".

NENI 8

¹ Shoqëria "Digit Alb" shpk do t'a ketë selinë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Qendra Ndërkombëtare e Kulturës, Tiranë.

² Nëpërmjet miratimit me vendim të zotëruesve të një shumice prej 8/9^{sh} të zotëruesve të kapitalit themeltar, në mbledhjen e Ansamblesë së jashtëzakonëshme të Ortakëve selia e shoqërisë mund të ndryshohet.

KREU II

PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI I TYRE

NENI 9

¹ Bazuar në nenin 7 të këtij Statuti ortakët themelues kanë kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë së më poshtë:

- a.** Ortaku **DRITAN HOXHA**, i biri i Fiqiriut, i lindur në 1968, banues në Tiranë, ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 560'000 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) Euro.
- b.** Ortaku **PETRAQ SHOMO**, i biri i Dhimitraqit, i lindur në 1963, lindur dhe banues në Tiranë, ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 80'000 (tetëdhjetë mijë) Euro.
- c.** Ortaku **ARBEN TAIP**, i biri i Ahmetit, i lindur në 1965, lindur dhe banues në Tiranë, ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 80'000 (tetëdhjetë mijë) Euro.

- d.** Ortaku **ENKELEJDI JOTI**, i biri i Kristaqit, i lindur në 1969, lindur dhe banues në Tiranë, ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 26,666 (njetzet e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhjetë e gjashtë) Euro.
- e.** Ortaku **ALBAN JAHO**, i biri i Nuriut, i lindur në 1969, banues në Tiranë, ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 26,666 (njetzet e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhjetë e gjashtë) Euro..
- f.** Ortaku **Eduard Poda**, i biri Shpetimit, lindur ne 2 Korrik 1968 Tirane, ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë me 26,666 (njetzet e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhjetë e gjashtë) Euro.

NENI 10

Kapitali Themeltar i "Digit Alb" shpk ndahet në 800 (tetëqind) pjesë me vlerë 1'000 (një mijë) Euro secila.

NENI 11

Pjesët e kapitalit themeltar do të ndahen mes ortakëve si më poshtë:

1. Ortaku **DRITAN HOXHA** merr 560 (pesëqind e gjashtëdhjetë) pjesë që përbëjnë 70 % (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku **PETRAQ SHOMO** merr 80 (tetëdhjetë) pjesë që përbëjnë 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Ortaku **ARBEN TAIP** merr 80 (tetëdhjetë) pjesë që përbëjnë 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
4. Ortaku **ENKELEJDI JOTI** merr 26.4 (njetzete e gjashte pike kater) pjesë që përbëjnë 3.33 % (trepiketredhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
5. Ortaku **ALBAN JAHO** merr 26.4 (njetzete e gjashte pike kater) pjesë që përbëjnë 3.33 % (trepiketredhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
6. Ortaku **Eduard Poda** merr 26.4 (njetzete e gjashte pike kater) pjese qe perbejne pjesë që përbëjnë 3.33 % (trepiketredhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë

NENI 12

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar për efekt vlefshmërie duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet si në librat e shoqërisë ashtu edhe në Zyrën e Regjistrimit Tregëtar.

NENI 13

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

NENI 14

¹ Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, jo ortakë, duhet miratohet nga Asambleja e zakonëshme e Ortakëve me vendim të shumicës prej $\frac{3}{4}$ -sh të zotëruesve të kapitalit themeltar.

² Sipas të njëjtës procedurë secili nga ortakët mund të lërë peng, të përdorë si garanci për shlyerjen e detyrimeve apo të cedojë çfarëdolloj të drejte mbi pjesët e tij të kapitalit themeltar, në emër të të tretëve.

NENI 15

¹ Për transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar nga njëri nga ortakët tek trashëgimtarët e tij duhet të kërkohet më parë miratimi i ortakëve të tjerë, të cilët vendosin për transferimin në bazë të shumicës së kapitalit themeltar të mbetur pas heqjes së pjesës së ortakut, pjesët e të cilit transferohen për shkak të trashëgimisë.

² Në një rast të tillë në quorumin e votimit nuk llogariten pjesët e kapitalit themeltar objekt transferimi dhe as vota e ortakut subjekt votimi, apo mandatmbajtësit të tij.

NENI 16

¹ Asambleja e Ortakëve duhet të miratojë kalimin e pjesëve të kapitalit themeltar nga një ortak tek bashkëshorti për shkak të pjestimit të pasurisë mes bashkëshortëve, duke votuar në bazë të procedurës së përshkruar në nenin e mësipërm.

² Në këtë votim ortakun, pjesët e të cilit janë objekt pjestimi, mund të marrë pjesë vetëm me pjesët që i mbeten proporcionalisht nga kapitali themeltar pas pjestimit të pasurisë bashkëshortore.

³ Pjesët e kapitalit themeltar, që për shkak të pjestimit duhet t'i kalojnë bashkëshortit, nuk llogariten në quorumin e votimit.

NENI 17

Në vendimin e Ansamblesë së Ortakëve që ndalon kalimin e pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët jo ortakë, trashëgimtarët apo bashkëshorti, duhet të përcaktohet dhe mënyra e kompensimit të të tretëve subjekte të transferimit, si dhe modalitetet e kalimit të pronësisë të pjesëve të kapitalit themeltar objekt vendimi.

NENI 18

¹ Veprimet e kryera në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenet 13 deri 17 të këtij Statuti janë të pavlefshme.

² Nëse, për lajthithje të çfarëdolloji, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar i bërë në kundërshtim me këto rregulla rregjistrohet në librat e shoqërisë dhe/ose në regjistrin tregtar, çdo i interesuar mund të kërkojë anulimin e këtyre veprimeve për pavlefshmëri.

KREU III

STRUKTURA

NENI 19

¹ Asambleja e Ortakëve është organi suprem i shoqërisë "Digit Alb" shpk.

² Ajo përbëhet nga të gjithë ortakët me të drejtë vote të pranishëm në mbledhjen përkatëse.

³ Asambleja funksionon sipas përcaktimeve të bëra në kreun e katërt të këtij statuti dhe dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 20



¹ Administrimi i aktivitetit të përditshëm financiar të shoqërisë do të bëhet nga Administrator i Pergjithshemi i emëruar nga Asambleja, sipas përcaktimeve të bëra në statut.

² Administrator i Pergjithshem i shoqërisë "Digit Alb" shpk mund të zgjidhet çdo person me zotësi të plota juridike për të vepruar, që ka banim ose seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë.

³ Administratori i Pergjithshem nëpërmjet statutit, aktit të emërimit dhe procedurave përkatëse i jepet autoriteti ligjor për të përfaqësuar shoqërinë në mardhëniet me të tretët.

⁴ Administratori i Pergjithshem i shoqërisë gjatë veprimtarisë së tij në këtë detyrë duhet t'ju përmbahet dispozitave ligjore, statutit dhe vendimeve të Ansamblesë.

NENI 21

¹ Aktiviteti financiar i shoqërisë kontrollohet nga ekspertët kontabël të emëruar nga Asambleja sipas dispozitave të kreut të gjashtë të statutit.

² Nuk është kompetencë e ekspertve kontabël të kontrollojnë veprimtari tjetër veç asaj financiare të shoqërisë.

KREU IV

ASAMBLEJA E SHOQËRISË, VENDIM-MARRJA

NENI 22

¹ Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendim-marrës i shoqërisë.

² Ajo mbledhet në seanca të zakonshme të paktën çdo gjashtë muaj.

³ Mbledhja e zakonshme e Ansamblesë thirret nga Administrator i Pergjithshem dhe drejtohet me rotacion nga ortakët, ose nga personi i autorizuar prej tyre me vendim të Ansamblesë.

⁴ Në mbledhjet e Ansamblesë marrin pjesë me të drejtë vote ortakët që zotërojnë të paktën 5 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, ose përfaqësuesit e tyre me prokurë.

⁵ Ortakët që zotërojnë më pak se 5 % të kapitalit themeltar mund të emërojnë një përfaqësues të përbashkët, apo të delegojnë një ortak tjetër për të votuar për llogari të tyre në përpjestim me pjesën e kapitalit themeltar që ata zotërojnë.

⁶ Përfaqsimet e mësipërme bëhen me prokurë të posaçme konform nenit 135 të ligjit 7639 dt. 19 Nëntor 1992 "Për shoqëritë tregtare".

NENI 23

Në mbledhjet e Ansamblesë mund të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe Administrator i Pergjithshemi i shoqërisë (kur ky nuk është ortak), ekspertët kontabël të autorizuar, si dhe çdo person tjetër i thirrur nga organizatorët e mbledhjes për mbarëvajtjen e saj.

NENI 24

¹ Ortakët dhe personat që do të marrin pjesë në mbledhjen e Ansamblesë duhet të njoftohen me shkrim të të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara për mbledhjen e Ansamblesë, qoftë kjo e zakonshme apo e jashtëzakonshme.

² Njoftimi për mbledhjen duhet të përmbajë:

a. kohën (datë dhe orë)

b. vendin

C. rendin e ditës.

³ Ortakët eventualisht duhet të njoftohen edhe për personat e tjerë që do të thirren dhe për arësyen e thirrjes së tyre në mbledhjen e Ansamblesë.

⁴ Organizatorët e mbledhjes në njoftim mund të kërkojnë nga ortakët që brenda një afati të caktuar të konfirmojnë prezencën e tyre në mbledhje nëpërmjet akteve të shkruar, apo me mënyra të tjera të provueshme komunikimi.

⁵ Për efekt vlefshmërie dërgimi i njoftimeve për mbledhjen e Ansamblesë dhe marrja e tyre në dorëzim nga ortakët duhet të pasqyrohen në librat e protokollit të shoqërisë ose/dhe të arkivohen të shoqëruara me mandatet postare përkatëse.

NENI 25

¹ Ortakët, që gjenden në pamundësi për t'u paraqitur në mbledhjen e Ansamblesë, për të cilën janë njoftuar sipas nenit të mësipërm, mund të kërkojnë nga organizatorët e mbledhjes që mbledhja e caktuar në këtë datë të shtyhet në një datë tjetër nëpërmjet një kërkesë me shkrim që duhet t'ju dorëzohet organizatorëve apo Administratorit të Përgjithshëm të paktën 5 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes.

² Kërkesa për shtyrje nuk mund të aplikohet më shumë se një herë për çdo mbledhje nga cilido ortak.

³ Data e caktuar nga organizatorët për zhvillimin e mbledhjes së shtyrë sipas paragrafit të parë të këtij neni, nuk duhet të jetë më vonë se dy muaj nga data e caktuar fillimisht.

NENI 26

¹ Mbledhja e Ansamblesë është e pavlefshme kur njoftimet e shpërndara për ortakët janë të parregullta për sa i përket rrespektimit të afateve apo të përmbajtjes, ose kur ajo është zhvilluar pa marrë parasysh kërkesën e rregullt të një ortaku për shtyrjen e datës së saj.

² Kur me gjithë njoftimin e parregullt të gjithë ortakët kanë marrë pjesë dhe kanë votuar në mbledhjen e Ansamblesë, kjo dhe vendimet e marra në të nuk mund të kontestohen si të pavlefshme për shkak të njoftimit.

³ Kur megjithë njoftimet e rregullta në mbledhjen e Ansamblesë nuk janë të pranishëm ortakë që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar, organizatorët shtyjnë mbledhjen dhe caktojnë një datë brenda një muaji për përsëritjen e mbledhjes.

⁴ Për zhvillimin dhe vlefshmërinë e mbledhjes së përsëritur sipas paragrafit të mësipërm quorumi i pjesëmarrjes nuk është i nevojshëm, por sidoqoftë mbledhja nuk mund të zhvillohet me një ortak të vetëm.

NENI 27

¹ Për marrjen e vendimeve në mbledhjet e Ansamblesë pesha e votës dhe shumica përcaktohet nga pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara nga ortaku votues, apo përfaqesuesi i tij.

² Për çështjet që nuk kërkojnë shumicë të cilësuar sipas këtij statuti, vendimet merren kur votojnë në favor ose kundër propozimit ortakë që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar të pranishëm në mbledhje.

³ Kur shumica e kërkuar nga paragrafi i mësipërm nuk arrihet në votimin e parë votimi përsëritet për herë të dytë.

⁴ Nëse edhe pas votimit të dytë shumica e kërkuar nuk arrihet, përcaktuese është vota e ortakut që zotëron pjesën më të madhe të kapitalit themeltar.

NENI 28

¹ Duhet të votojnë në favor ortakë që zotërojnë të paktën 8/9^{at} e kapitalit themeltar për:

- a.** ndryshimin e dispozitave të statutit,
- b.** emërimin e Administratorit,
- c.** miratimin e rregullores së brendëshme të shoqërisë apo ndryshimin e dispozitave të saj,
- d.** prishjen e parashikimit të shoqërisë për shkaqet e parashikura në statut,
- e.** investimet apo marrvëshjet që kalojnë në vlerë 25 % (njëzet e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

² Kur në mbledhjen e Ansamblesë nuk arrihet shumica e cilësuar në paragrafin e mësipërm për marrjen e një vendimi apo për rrëzimin e propozimit, bëhet një votim i dytë në të cilin vendimi mund të mirret nëse votojnë në favor ose kundër zotëruesit e 3/4 së kapitalit themeltar.

³ Kur edhe pas votimit të dytë nuk arrihet shumica e kërkuar në këtë nen, çështja kalon për shqyrtim në mbledhjen e ardhëshme të Ansamblesë, por jo më shumë se dy herë rradhazi.

⁴ Në përfundim të mbledhjes së tretë nëse propozimi nuk është miratuar apo hedhur poshtë me votim nga Ansambleja, konsiderohet për efekt të statutit se ai nuk është pranuar dhe nuk mund të përfshihet në rendin e ditës të një mbledhje Ansambleje për vitin kalendarik në vazhdim.

NENI 29

¹ Me propozim të cilitdo nga pjesëmarrësit në mbledhjen e Ansamblesë dhe vendim me shumicë të thjeshtë të pjesëmarrësve në mbledhje, rendi i ditës i përcaktuar nga organizatorët në njoftim mund të ndryshohet, shtohet apo pakësohet sipas rastit duke shtuar apo hequr propozime për votim.

² Propozimi për përfshirjen, ndryshimin apo heqjen nga rendi i ditës, të propozimeve për votimin e të cilave kërkohet shumicë e cilësuar sipas nenit 28 të statutit, duhet të miratohet nga zotëruesit e shumicës së kapitalit themeltar.

NENI 30

¹ Vendimet e Ansamblesë janë të vlefshme nëse propozimet e votuara janë në rendin e ditës të mbledhjes dhe në votim kanë marrë pjesë personalisht apo të përfaqësuar ortakë që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar.

² Nga ky rregull bëjnë përjashtim rastet:

- a.** kur në statut për marrjen e vendimeve kërkohet shumicë e cilësuar,
- b.** parashikohet procedurë e veçantë për shqyrtimin e vendimeve,
- c.** kur rishqyrtohen vendimet e marra në korespondencë sipas nenit 32 të statutit.

Vendimet, që nuk kërkojnë shumicë të cilësuar sipas statutit, janë të vlefshme edhe nëse propozimet miratohen ose rrëzohen me shumicën e zotëruesve kapitalit të pranishëm në mbledhje.

NENI 31

¹ Administratori, apo mandatmbajtësit e emëruar konform ligjit të ortakëve që zotërojnë të paktën 5 % të kapitalit themeltar, mund të thërrasin në çdo kohë në mbledhje të jashtëzakonëshme Ansamblenë e Ortakëve.

² Për njoftimin e pjesëmarrësve duhet rrespektuar procedura e parashikuar në këtë Statut për thirrjen e mbledhjes së zakonëshme të Ansamblesë.

NENI 32

¹ Vendimet e Ansamblesë janë të vlefshme edhe kur ortakët për miratimin apo refuzimin e propozimeve janë konsultuar me shkrim nga Administrator i Pergjithshem apo çdo person tjetër i autorizuar nga ligji apo statuti për thirrjen e mbledhjes së Ansamblesë.

² Komunikimet me shkrim duhet të jenë të hartuara në formën e njoftimeve noteriale dhe si kusht vlefshmërie duhet të përmbajnë:

- a.** datën e marrjes dijeni për popozimin,
- b.** datën e votimit
- c.** votën e ortakut pro ose kundër propozimit, ose abstenimin e shprehur të tij.
- d.** nënshkrimin

³ Nëse në emër të ortakut komunikimi bëhet me mandatmbajtësin e tij bashkangjitur komunikimit të votës duhet të dërgohet edhe prokura e posaçme që autorizon përfaqësimin.

Mospërgjigja e ortakut pa shkak të përligjur, kur ky ka marrë njoftimin, konsiderohet mospjesmarrje.

⁴ Edhe për këtë lloj të veçantë votimi duhet të mbahen parasysh rregullat për quorumin dhe shumicën e vendim-marrjes të përcaktuara në nenet 26 deri 30 të statutit.

⁵ Vendimet e marra nga Asambleja sipas procedurës së përshkruar në këtë nen duhet të kalojnë për rishqyrtim në mbledhjen më të afërt të Ansamblesë, në të kundërt në përfundim të kësaj mbledhje anulohen apo mbeten pa fuqi, dhe sipas rastit mund të kërkohet pavlefshmëria e tyre nga çdo i interesuar.

⁶ Përfshirja e tyre në rendin e ditës bëhet sipas procedurës së neneve 24 dhe 29 të statutit.

NENI 33


Janë kompetenca ekskluzive të Ansamblesë:

- a.** Ndryshimi i dispozitave të Statutit.
- b.** Emërimi i Administrator i Pergjithshemit dhe shkarkimi i tij.
- c.** Emërimi dhe shkarkimi i Administrator i Pergjithshemëve të filialeve të shoqërisë.
- d.** Vendimet që përcaktojnë politikën e drejtimit të shoqërisë.
- e.** Miratimin ose mospranimin e propozimeve të Administrator i Pergjithshemit për kushtet e kontratave të punës për personelin e shoqërisë.
- f.** Emërimi dhe shkarkimi i ekspertve kontabël të autorizuar.
- g.** Miratimi i Rregullores së Brendshme të shoqërisë dhe ndryshimi i dispozitave të saj.
- h.** Miratimi i raportit vjetor të administrimit të shoqërisë.
- i.** Miratimi i marrveshjeve apo investimeve që kalojnë në vlerë 25 % të vlerës së kapitalit themelar të shoqërisë.
- j.** Miratimi i strukturës organike të shoqërisë dhe ndryshimeve të saj.

KREU V

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 34



¹ Për drejtimin e aktivitetit të shoqërisë ortakët që zotërojnë një shumicë prej të paktën 8/9^{sh} të kapitalit themeltar emërojnë një Administrator i Pergjithshem, i cili qëndron në detyrë sipas këtij emërimi për një mandat 3 (tre) vjeçar, me të drejtë riemërimi.

² Administrator i Pergjithshem i emëruar mund të jetë ortak i shoqërisë, ose një person tjetër i zgjedhur në bazë të aftësive administruese dhe pregtitjes profesionale.

³ Në vendimin e Ansamblesë për emërimin e Administrator e Pergjithshem, përcaktohen dhe kushtet e kontratës së tij të punës.

⁴ Për mandatin e parë 3-vjeçar themeluesit emërojnë Administrator i Pergjithshem, ortakun Dritan Hoxha i biri i Fiqiriut, i lindur në 1968, banues ne Tiranë.

NENI 35

Emri i shoqërisë, i Administrator te Pergjithshem, si dhe vula e shoqërisë duhet të figurojë në të gjitha shkresat zyrtare të shoqërisë si dhe në dokumentat që kanë të bëjnë me përmbushjen e objektit, apo që i shërbejnë ushtrimit të aktivitetit të saj.

NENI 36

¹ Administrator i Pergjithshem përfaqëson shoqërinë në mardhëniet me të tretët, duke zbatuar politikën e drejtimit të shoqërisë të përcaktuar në bazë të vendimeve të Ansamblesë së Ortakëve.

² Në raste të veçanta Administrator i Pergjithshem mund të autorizojë me prokurë të posaçme konform dispozitave përkatëse të Kodit Civil, një person të tretë, të përfaqësojë shoqërinë.

NENI 37

¹ Administrator i Pergjithshem, mban përgjegjësi për shkeljen e ligjit, statutit, rregullores së brendëshme apo vendimeve të Ansamblesë, para Asamblesë, të tretëve dhe instancave ligjore.

² Secili nga ortakët mund të kërkojë nga Asambleja e Ortakëve fillimin e një procedure hetimi për Administrator i Pergjithshem duke paraqitur prova për shkelje apo, keqadministrim.

³ Asambleja me vendim të ortakëve që zotërojnë shumicën e kapitalit themeltar fillon procedurën e hetimit dhe mund të pezullojë gjatë kësaj kohe nga detyra Administrator i Pergjithshem e hetuar.

⁴ Në përfundim të procedurës së hetimit Administrator i Pergjithshemi i gjetur në shkelje, apo për të cilin është konstatuar keqadministrim, përveç shkarkimit nga detyra, mund të detyrohet të dëmshpërblejë shoqërinë për pasojat e ardhura nga veprimet e tij të pa mbështetura në ligj, statut, apo vendime të Ansamblesë.

NENI 38

¹ Në përfundim të çdo viti financiar Administrator i Pergjithshem pregtit *Raportin Vjetor të Administrimit*, i cili duhet t'i paraqitet Ansamblesë së Ortakëve për miratim jo më vonë se 3 (tre) muaj nga përfundimi i vitit financiar.

² Së bashku me Raportin Vjetor të Administrimit ortakëve duhet t'ju paraqiten edhe inventaret dhe llogaritë vjetore.

³ Për shqyrtimin e Raportit Vjetor të Administrimit nga Asambleja, zbatohen rregullat e përgjithshme për propozime dhe vendim-marrje në mbledhjet e Ansamblesë.

NENI 39

¹ Administrator i Pergjithshemi çdo gjashtë muaj cakton datën, kohën, vendin, harton rendin e

ditës dhe shpërndan njoftimet, konform nenit 24 të statutit, për thirrjen e mbledhjes së zakonëshme të Ansamblesë së Ortakëve.

² Administrator i Pergjithshemi merr pjesë me të drejta të plota në debatin e mbledhjes, por nuk ka të drejtë vote kur nuk është ortak i shoqërisë.

NENI 40

¹ Administrator i Pergjithshemi ka të drejtë të japë dorëheqje nga funksioni i tij në çdo moment që e quan të arsyeshme duke marrë masa që brenda një muaji nga dorëheqja e tij të organizohet një mbledhje e Ansamblesë për emërimin e një Administratori të ri të Pergjithshem.

² Nëse Administrator i Pergjithshemi e ka të pamundur të qëndrojë në detyrë për periudhën mes dorëheqjes dhe emërimit nga Asambleja të një Administratori të Pergjithshemi të ri, ai duhet të caktojë për drejtimin e shoqërisë një Administrator i Pergjithshem të Komanduar, me kompetenca të kufizuara, që nuk i tejkalojnë ato të një drejtimi normal të shoqërisë, duke marrë më parë për këtë, me korespondencë, miratimin e ortakëve sipas procedurës së përshkruar në nenin 32 të statutit.

NENI 41

¹ Për Administratorin Pergjithshemin në përcaktimin e politikës së drejtimit dhe administrimit të shoqërisë janë të detyrueshme vetëm vendimet e Ansamblesë.

² Konsultat, kërkesat apo çdo lloj tjetër komunikimi mes ortakëve dhe Administratorit të Pergjithshemit, që nuk paraqitet në formën e një vendimi të Ansamblesë së Ortakëve nuk përmbajnë asnjë detyrim ligjor, apo statutor zbatimi për Administratorin Pergjithshemin.

NENI 42

¹ Administrator i Pergjithshemi ka për kompetencë:

- a.** Përfaqësimin e shoqërisë në mardhëniet me të tretët.
- b.** Drejtimin e aktivitetit të shoqërisë ë bazë të objektit të saj dhe politikës së drejtimit dhe administrimit të përaktuar në vendimet e Ansamblesë.
- c.** Punësimin e personelit të administratës dhe të shërbimit të shoqërisë.
- d.** Përcaktimin dhe sanksionimin e kushteve të kontratave të punës për personelin, pas marrjes së miratimit nga Asambleja.
- e.** Thirrjen e mbledhjes së zakonëshme të Ansamblesë së Ortakëve.
- f.** Hartimin dhe paraqitjen e Raportit Vjetor të Administrimit të shoqërisë në mbledhjen e Ansamblesë së Ortakëve.

² Gjithashtu Administrator i Pergjithshemi është i detyruar të kryejë të gjitha veprimet e tjera të administrimit të zakonshëm në interes dhe në emër të shoqërisë për sa kohë që këto veprime nuk i janë ndaluar apo pezulluar nga një vendim i Ansamblesë së Ortakëve.

NENI 43

¹ Administrator i Pergjithshem mund të shkarkohet me vendim të Ansamblesë së Ortakëve para mbarimit të mandatit të tij kur:

- a.** Janë vërejtur dhe faktuar shkelje të rënda të Statutit, Rregullores së Brendëshme, politikës drejtuese të shoqërisë, apo vendimeve të Ansamblesë.
- b.** Vërtetohet se gjatë drejtimit ka patur keqadministrim të burimeve dhe potencialit të shoqërisë.
- c.** Vërtetohet me vendim gjyqësor se gjatë aktivitetit, ka shkelur ligjin në dëm të shoqërisë.



d. Gjenden është në pamundësi për të vazhduar ushtrimin e detyrës.

e. Gjykohet nga Asambleja se personi që është në detyrën e Administrator i Përgjithshëm nuk i përshtatet këtij pozicioni për shkak të kualifikimit të tij apo për arsye të tjera të lidhura me aftësitë e administrimit.

² Për shkarkimin e Administratori Përgjithshëm duhet të votojnë në favor ortakët që zotërojnë të paktën 8/9^{ta} e kapitalit themeltar të shoqërisë.

³ Në vendimin e Ansamblesë për shkarkimin e parakohshëm të Administrator te Përgjithshëm ortakët duhet të shprehën:

a. për arsyet e largimit,

b. për rregullimin e të drejtave financiare,

c. si dhe të drejtave dhe detyrimeve të tjera të rrjedhura nga marrëdhënia e tij me shoqërinë.

⁴ Një kopje e këtij vendimi duhet t'i vihet në dispozicion Administrator i Përgjithshëm të shkarkuar.

NENI 44

Shoqëria nuk merr përsipër detyrime që rrjedhin nga akte, apo veprime juridike të Administratorit te Përgjithshëm, apo Rektorit kur këto nuk i janë përmbajtur objektit të aktivitetit shoqërisë, ose nuk janë në shërbim të përmbushjes së këtij objekti.

KREU VI

AKTIVITETI DHE KONTROLLI FINANCIAR I SHOQËRISË

NENI 45

Viti financiar i shoqërisë "Digit Alb" shpk. fillon më datë 1 Janar të çdo viti dhe përfundon më datë 31 Dhjetor po këtij viti.

NENI 46

¹ Me vendim të Ansamblesë për kontrollin e llogarive dhe veprimtarisë së shoqërisë mund të emërohen një ose disa ekspertë kontabël.

² Në vendimin e Ansamblesë për emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar përcaktohen:

a. detyrat,

b. kufijtë e kompetencës,

c. kohëzgjatja e emërimit,

d. masa e shpërblimit,

e. kur është rasti edhe afati për përgatitjen e raportit të kontrollit.

NENI 47

¹ Në vendimin e Ansamblesë për emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar duhet të përcaktohen edhe një ose disa zëvendës-ekspertë të cilët thirren për të zëvendësuar titullarët në rastet e mospranimit, pengimit, dorëheqjes, shkarkimit apo vdekjes.



² Me marrjen e funksionit zëvendës-ekspertët kanë të njejtat detyra dhe kufij kompetence të përcaktuara nga vendimi i Ansamblesë për emërimin e ekspertëve.

³ Me një vendim tjetër të Ansamblesë mund të ndryshohen afatet e parashikuara në vendimin e parë konform gërmës "e" të nenit 47 të statutit.

NENI 48

¹ Gjatë mandatit të tij të përcaktuar me vendim të Ansamblesë eksperti kontabël i autorizuar merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Ansamblesë, të cilat në rendin e ditës kanë çështje që kanë të bëjnë me detyrat që i janë ngarkuar atij.

² Në këto mbledhje eksperti kontabël i autorizuar ka të drejtë të shprehë mendimin e tij në lidhje me çështjet që diskutohen.

³ Gjithashtu eksperti kontabël ka të drejtë të marrë pjesë dhe të dëgjohet dhe në mbledhjen e Ansamblesë ku me përfundimin e mandatit të emërimit, diskutohet zëvendësimi i tij.

NENI 49

¹ Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet nga detyra me vendim të Ansamblesë kur:

- a.** Nuk ka përbushur detyrat e përcaktuara në vendimin e Ansamblesë për emërimin e tij, brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim.
- b.** Vërtetohet se ka konflikt ineresash, pasi personi i emëruar ka lidhje familjare, pune apo të çfarëdolloji tjetër që mund të ndikojnë në kryerjen e detyrës prej tij.
- c.** Vërtetohet se ka kryer veprime në dëm të shoqërisë apo ka përfituar padrejtësisht nga aktiviteti i shoqërisë.
- d.** I është hequr e drejta për të ushtruar profesionin e ekspertit kontabël të autorizuar.
- e.** Ka shkelur sekretin profesional në dëm të shoqërisë.
- f.** Kur Asambleja e Ortakëve me një shumicë prej të paktën 8/9^{sh} të zotëruesve të kapitalit themeltar konform nenit 65 të ligjit 7638 "Për shoqëritë tregtare", vendos që shërbimi i ekspertit nuk është më i nevojshëm për shoqërinë.

² Me shkarkimin e ekspertit kontabël të autorizuar thirret për t'a zëvendësuar atë në detyrë zëvendës eksperti i përcaktuar në vendimin e Ansamblesë për emërimin e tij.

³ Nga paragrafi i mësipërm bën përjashtim rasti i parashikuar nga pika "f" e paragrafit të parë, rast në të cilin Asambleja e Ortakëve shfuqizon vendimin e emërimit dhe asnjëri nga zëvendës ekspertët nuk emërohet në detyrë.

NENI 50

¹ Çdonjëri nga ortakët apo mandatmbajtësit e tyre të emëruar përfaqësues në mbledhjet e Ansamblesë, ka të drejtë të kërkojë t'i vihen në dispozicion dokumentat financiare të shoqërisë. Kjo e drejtë shtrihet për dokumenta që kanë të bëjnë me aktivitetin e shoqërisë për tre vitet e fundit financiare.

² Për studimin e këtyre dokumentave ortaku mund të autorizojë personalisht një ekspert kontabël, duke përballuar vetë shpenzimet ndaj tij.

³ Një kopje e raportit të ekspertit kontabël të emëruar nga ortaku për kontrollin e dokumentave të shoqërisë duhet t'i vihet në dispozicion Administrator te Pergjithshem ose Shoqërisë.

⁴ Përveç kësaj ortakët mund të kërkojnë informacion me shkrim nga Administrator i Pergjithshemi apo ekspertët kontabël të autorizuar për gjendjen financiare të shoqërisë. Këta të fundit janë të detyruar t'i përgjigjen kërkesës së ortakut me shkrim brenda 15 ditëve.

NENI 51

Të ardhurat e shoqërisë do të vijnë nga kryerja e aktivitetit tregtar, si dhe nga çdo burim tjetër i lejueshëm nga legjislacioni shqiptar.

NENI 52

¹ Në përfundim të vitit financiar, pas miratimit të Raportit Vjetor të Administrimit nga Asambleja e Ortakëve, fitimi neto i vitit financiar ndahet mes ortakëve në formën e dividendëve.

² Fitimi neto i vitit financiar llogaritet duke i zbritur fitimit të realizuar gjatë vitit financiar humbjet e vitit të mëparshëm, e duke depozituar pastaj në *Fondin e Rezervës së Domosdoshme* 5 % (pesë përqind) të pjesës së mbetur të fitimit.

³ Asambleja mund të vendosë të ndërpresë depozitimet në Fondin e Rezervës së Domosdoshme kur shuma e depozituar në këtë fond ka kaluar 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

⁴ Pjesa e fitimit e mbetur pas zbritjeve të mësipërme ndahet në formën e dividendëve mes ortakëve, duke u bazuar për këtë ndarje në përqindjen e pjesëve të kapitalit themeltar që zotëron secili nga ortakët.

KREU VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 53

¹ Shoqëria "Digit Alb" shpk do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të këtij statuti apo të ndryshimeve të mëvonëshme të tij deri në përfundim të afatit të parashikuar në nenin 4 të Statutit.

² Përpara përfundimit të këtij afati shoqëria mund të pushojë së ekzistuari me prishjen e shoqërisë me vendim të Ansamblesë, për shkak të rrethanave të parashikuara në ligj, apo në statut.

NENI 54

¹ Përveç rasteve të parashikuara nga ligji, prishja e shoqërisë mund të kërkohet në Gjykatë nga ortakët, Administrator i Pergjithshemi, apo personat e interesuar kur verifikohet një nga rrethanat e mëposhtëme:

- a.** Kur për tre vitet e fundit financiare shoqëria ka pësuar humbje prej të paktën 10% të kapitalit të saj themeltar në vit.
- b.** Kur gjatë gjithë aktivitetit të saj shoqëria ka humbur 50 % të kapitalit themeltar.
- c.** Kur shoqëria nuk ka ushtruar aktivitet për një periudhë prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh.
- d.** Kur ortakët vendosin me unanimitet shndërrimin e shoqërisë në një formë tjetër apo bashkimin e saj me një shoqëri tjetër tregëtare.

² Është e detyrueshme që gjatë gjykimit të këkesës së bërë sipër këtij neni të thirren të marrin pjesë Administrator i Pergjithshemi i shoqërisë dhe të gjithë ortakët.

NENI 55



Handwritten signatures and initials at the bottom of the page, including a signature with the number 13 written below it.

¹ Pas vendimit të Ansamblesë apo verifikimit të rrethanave për prishjen e shoqërisë të parashikuara në statut apo ligje, me vendim të Ansamblesë apo të Gjykatës emërohet një likuidator dhe shoqëria hyn në procedurën e likuidimit.

² Në vendimin e emërimit të Likuidatorit Asambleja përcakton, kompetencat dhe kushtet e kontratës së punës të likuidatorit.

³ Tagrat e likuidatorit nuk duhet të tejkalojnë shitjen e aktiveve, vjeljen e kredive të shoqërisë, likuidimin e llogarive dhe shlyerjen e detyrimeve.

⁴ Në përfundim të procedurës së likuidimit Likuidatori duket t'i paraqesë për miratim Ansamblesë raportin e likuidimit dhe bilancin përfundimtar.

NENI 56

Për zgjidhjen e të gjitha mosmarrveshjeve mes ortakëve, për interpretimin e dispozitave të Statutit, të Rregullores së Brendëshme apo të vendimeve të Ansamblesë së Ortakëve kompetente do të jetë Gjykata e vendit ku shoqëria do të ketë selinë, dhe do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

ORTAKËT THEMELUES

DRITAN HOXHA

Dritan Hoxha

PETRAQ SHOMO

Petraq Shomo

ARBEN TAIPI

Arben Taip

EDUARD PODA

Eduard Poda

ENKELEJDI JOTI

Enkeljdi Joti

ALBAN JAHO

Alban Jaho

Republika e Shqipërisë
Dhoma e Noterëve Tiranë

Nr. 1217 Rep. në. 97 kal.

Vërtetim nënshkrimi

Sot më datë 25 Mars 2004 (dymijë e katër) në Tiranë para meje Violanda Beci notere e Dhomës së Noterëve Tiranë që ushtroj aktivitetin në zyrën e ndodhur në rrugën e Durrësit u paraqitën personalisht personalisht:

Z. **DRITAN HOXHA**, i biri i Fiqiriut, i lindur në 1968, banues ne Tiranë, i njohur personalisht prej meje Noteres.

Z. **PETRAQ SHOMO**, i biri i Dhimitraqit, i lindur në 1963, lindur dhe banues ne Tirane, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta e tij e shërbimit nr. 0011949,

Z. **ARBEN TAIPI**, i biri i Ahmetit, i lindur në 1965, lindur dhe banues ne Tiranë, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta e tij e shërbimit 0011954,

Z. **ENKELEJDI JOTI**, i biri i Kristaqit, i lindur në 1969, lindur dhe banues në Tiranë, i njohur personalisht prej meje Noteres,

Z. **ALBAN JAHO**, i biri i Nuriut, i lindur në 1969, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta e tij nr.1543599.

Z. **EDUARD PODA** i biri i Shpetimit, i lindur ne 1968, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta e tij nr. Z0891717

Të gjithë madhorë me zotesi juridike dhe për të vepruar të cilët deklaruan para meje se kanë hartuar me vullnet të lirë statutin që i bashkangjitet këtij vërtetimi, nënshkrimet në kopjen e aktit janë të tyret.


Unë noterja e vërtetoj aktin sipas ligjit.

NOTERE

VIOLANDA BECI



Violanda Beci



STATUTI
I SHOQERISE ANONIME
“DIGIT – ALB” SH.A

Ne baze te ligjit 7638, date 19/11/1992 “Per Shoqerite Tregtare”, dhe ligjit nr. 7667, date 28/01/1993 “Per Regjistrin Tregtar” aksioneret:

1. **Z. Dritan Hoxha**, i biri i Fiqiriut, i lindur ne 1968, banues ne Tirane;
2. **Z. Petraq Shomo**, i biri i Dhimitraqit, i lindur ne 1963, lindur dhe banues ne Tirane, me Nr.Pasaporte 0011949;
3. **Z. Arben Taipi**,i biri i Ahmetit, lindur ne 1965,lindur dhe banues ne Tirane, me Nr Pasaporte 0011954;
4. **Z. Euklejdi Joti**, i biri i Kristaqit, lindur ne 1969,lindur dhe banues ne Tirane;
5. **Z. Alban Jaho**, i biri i Nuriut,lindur ne 1969,lindur dhe banues ne Tirane, me Nr Pasaporte 1543599;
6. **Z. Eduard Poda**, i biri i Shpetimit,lindurme 1968, me Nr Pasaporte 0891717

Te cilet me poshte do te quhen themelues te shoqerise anonime me emertimin “**DIGIT – ALB**” **Sh.a.**, vendosen miratimin e ketij Statuti me dispozitat e meposhtme:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

FORMA

Krijohet Shoqeria Aksionere e tipit pa oferte publike, si Person Juridik dhe fiton personalitet juridik qe nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj.

NENI 2

EMERTIMI

Emertimi i shoqerise eshte **"DIGIT – ALB" Sh.a.**

Ne cdo akt te leshuar nga shoqeria eshte e detyrueshme te deklarohet **"DIGIT – ALB" Sh.a.**
(inicialet Sh.a. perfaqesojne tipin e Shoqerise)

NENI 3

SELIA

Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane, ne adresen, Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Qendra Nderkombetare e Kultures. Shoqeria mund te krijojte filiale, dege dhe perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë sipas nevojave të saj me vendim të Asamblesë së Jashtezakonshme të Aksionereve.

Dispozitat e këtij Statuti do të kenë fuqinë e normave themeltare për rregullimin normativ të aktivitetit të këtyre filialeve, degeve apo perfaqesive.

Selia mund të transferohet në çdo rreth tjetër me Vendimin e Asamblesë së Jashtezakonshme.

Keto vendime depozitohen në Regjistrin Tregtar.

NENI 4

STEMA DHE VULA E SHOQERISE

Shoqeria Anonime pa oferte publike "DIGIT – ALB" Sh.a. ka stemen dhe vulen e saj, e cila percaktohet nga mbledhja e pare e Asamblesë së Zakonshme të Shoqerise.

NENI 5

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e aktivitetit të Shoqerise do të jete për një periudhë të pacaktuar. Ajo fillon që në datën e regjistrimit në Regjistrin Tregtar të Gjykates së Shkalles së Pare Tirane.

Kohezgjatja e aktivitetit të Shoqerise mund të ndryshohet me vendim të aksionereve që zoterojnë $\frac{1}{4}$ e kapitalit themeltar në mbledhjen e Asamblesë së Jashtezakonshme të Aksionereve.

NENI 6

OBJEKTI

Objekti i veprimtarise se Shoqerise Anonime "DIGIT – ALB" Sh.a. eshte:

- Ndertimi dhe tregtimi i sistemeve te telekomunikacionit dhe transmetimeve televizive;
- Tregtimi i aparaturave per sistemet e transmetimit dhe marrjes se valeve televizive;
- Prodhimi, transmetimi dhe shitja ne menyre dixhitale e produkteve dhe sherbimeve audio e video.

Nepermjet miratimit me vendim te zoteruesve te nje shumice prej 8/9 te kapitalit themeltar ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve, brenda kufijve dhe konform modaliteteve te lejuara nga legjislacioni, mund te behet ndryshimi, shtimi ose pakesimi i aktiviteve qe perbejne objektin e shoqerise.

KREU II

NENSHKRIMI I KAPITALIT, AKSIONET DHE SHLYERJA E TYRE

NENI 7

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i Shoqerise Anonime "DIGIT – ALB" Sh.a. eshte 800,000.00 (teteqind mije) EURO, i ndare ne 800,000 aksione me nje vlere nominale prej 1 EURO secili, te numeruara me numer serie nga 1 deri ne 800,000.

Ne buletin e llogarise te shoqerise aksionere "DIGIT – ALB" Sh.a. krijohet fondi themeltar ku shenohet kapitali i aksionereve.

NENI 8

NENSHKRIMI I KAPITALIT

Nenshkrimi i kapitalit eshte bere nga aksioneret sipas menyres se meposhtme:

1. Aksioneri Dritan Hoxha, ka kontribuar ne kapitalin themeltar te shoqerise me shumen prej 560,002 (peseqind e gjashtedhete mije e dy) EURO.
2. Aksioneri Petraq Shomo, ka kontribuar ne kapitalin themeltar te shoqerise me shumen prej 80,000.00 (tetedhete mije) EURO.
3. Aksioneri Arben Taipi, ka kontribuar ne kapitalin themeltar te shoqerise me shumen prej 80,000.00 (tetedhete mije) EURO.
4. Aksioneri Enkelejdi Joti, ka kontribuar ne kapitalin themeltar te shoqerise me shumen prej 26,666 (njezet e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhete e gjashte) EURO.
5. Aksioneri Alban Jaho, ka kontribuar ne kapitalin themeltar te shoqerise me shumen prej 26,666 (njezet e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhete e gjashte) EURO.
6. Aksioneri Eduard Poda, ka kontribuar ne kapitalin themeltar te shoqerise me shumen prej 26,666 (njezet e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhete e gjashte) EURO.

Sipas derdhjeve te mesiperme:

1. Z.Dritan Hoxha, i perkasin 560,002 aksione me numer serie nga 1 deri ne 560,002 qe korespondojne me 70,01 % te kapitalit themeltar te Shoqerise Anonime "DIGIT - ALB" Sh.a.
2. Z.Petraq Shomo i perkasin 80,000 aksione me numer serie nga 560,003 deri ne 640,002 qe korespondojne me 10 % te kapitalit themeltar te Shoqerise Anonime "DIGIT - ALB" Sh.a.
3. Z.Arben Taipi i perkasin 80,000 aksione, me numer serie nga 640,003 deri ne 720,002 qe korespondojne me 10 % te kapitalit themeltar te Shoqerise Anonime "DIGIT - ALB" Sh.a.
4. Z.Enkelejdi Joti i perkasin 26,666 aksione, me numer serie nga 720,003 deri ne 746,668 qe korespondojne me 3.33 % te kapitalit themeltar te Shoqerise Anonime "DIGIT - ALB" Sh.a.
5. Z.Alban Jaho i perkasin 26,666 aksione, me numer serie nga 746,669 deri ne 773,334 qe korespondojne me 3.33 % te kapitalit themeltar te Shoqerise Anonime "DIGIT - ALB" Sh.a.
6. Z.Eduard Poda i perkasin 26,666 aksione, me numer serie nga 773,335 deri ne 800,000 qe korespondojne me 3.33 % te kapitalit themeltar te Shoqerise Anonime "DIGIT - ALB" Sh.a.

NENI 9

AKSIONERET E SHOQERISE

Aksioneret e Shoqerise Anonime "DIGITALB" SH.A jane:

1. Dritan Hoxha
2. Petraq Shomo
3. Arben Taipi
4. Enkelejdi Joti
5. Alban Jaho
6. Eduard Poda

Aksioneret e Shoqerise mund te jene persona fizik ose juridik vendas qe kane vene ose do te vene ne zoterim aksione te Shoqerise "DIGIT - ALB" Sh.a. me te gjitha menytrat e parashikuara ne ligj.

Pronesia mbi aksionet e shoqerise permban aderimin me te drejta te plota ne perputhje me kontributin perkates te aksionereve ne kapitalin e Shoqerise, Statutin e Shoqerise dhe ne Asamblene e Zakonshme dhe te Jashtezakonshme te Aksionereve.

NENI 10

LIBRI (REGJISTRI) THEMELTAR I REGJISTRIMIT TE AKSIONEREVE

Libri (Regjistri) i aksionereve, do te permbaje ne cdo kohe informacionin qe ka te beje me listat, emrat, mbiemrat, adresat e banimit te nenshkruesve te kapitalit, shumat e derdhura nga secili prej tyre dhe vleren nominale per cdo aksion te zoteruar. Ky regjister mbahet prane selise qendrore te shoqerise.

Cdo aksioner i shoqerise ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje ekstrakt nga libri themeltar i regjistrimit te aksioneve, i cili vertetohet me vulen e shoqerise.

Cdo aksioner ka te drejte te verifikojne ne cdo kohe nese emri i tij eshte futur ne librin e aksioneve. Procedura e verifikimit fillon me paraqitjen e kerkeses me shkrim nga aksioneri i interesuar.

NENI 11

TE DREJTAT DHE DETYRAT E AKSIONEREVE

Cdo aksioner i shoqerise ka te drejten e informimit mbi aktivitetin e shoqerise dhe dokumentacionin qe pasqyron kete aktivitet.

Cdo aksioner i shoqerise ka te drejten e pjesemarrjes ne shperndarjen e fitimeve te shoqerise ne perputhje me kontributin e tij ne kapitalin e shoqerise te nenshkruar dhe te paguar.

Cdo aksioner gezon te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asamblene e Pergjithshme te Aksionereve ne perputhje me numrin e aksioneve te zoteruara prej tij. Çdo aksion te jep te drejten e nje vote.

Te drejttat e mesiperme ndjekin aksionin ne cfaredo forme qe ai tjetersohet tek te tretet.

NENI 12

ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Zmadhimi i kapitalit themeltar behet nepermjet emetimit te aksioneve te reja ose nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve ekzistuese.

Kapitali themeltar mund te rritet pakufizim, ne cdo moment, nje apo disa here dhe vetem me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme, mbi bazen e raportit te paraqitur nga Drejtori I Pergjithshem.

Aksionet e reja shlyhen me para ne dore, me kompensim te nje kredie me para te kerkueshme dhe te detyruar per t'u shlyer nga shoqeria, me perfshirje te rezervave, fitimeve apo primeve te emetimit, me kontribut ne natyre ose me shnderrim te obligacioneve.

Zmadhimi i kapitalit nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve behet vetem me pelqimin unanim te aksionereve, me perjashtim te rastit kur ai realizohet me perfshirjen e rezervave, fitimeve apo primeve te emetimit.

Aksionet e reja emetohen me vleren nominale ose me vleren e rritur qe perfshin primet e emetimit.

Aksioneret kane te drejten e perparesise per nenshkrimin e aksioneve te shlyeshme ne para qe emetohen per zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejte eshte perpjestimore ne perputhje me shumen e aksioneve te zoteruara nga secili aksioner perpara zmadhimit te kapitalit.

Aksioneri mund te heqe dore vetem individualisht nga e drejta per nenshkrimin e aksioneve te reja.

NENI 13

ZVOGELIMI I KAPITALIT

Zvogellimi i kapitalit autorizohet dhe vendoset nga Asambleja e Jashtezakonshme ne mbledhjen e saj, e cila mund t'i jape Drejtorit te Pergjithshem te gjitha kompetencat per ta realizuar.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek aksionaret ne te njeten mase ne perpjesetim me vleren e aksioneve qe zoterojne.

Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar, te pakten 45 dite perpara mbledhjes se Asamblese se Aksionereve qe thirret per te vendosur mbi kete projekt. Asambleja merr vendimin mbi raportin e eksperteve kontabel, te cilet japin vleresimin e tyre mbi shkaqet dhe kushtet e zvogelimit.

Ky operacion realizohet nga Drejtori i Pergjithshem, i cili eshte i ngarkuar nga Asambleja. Ai harton nje procesverbal qe shpallet publikisht dhe vepron per ndryshimin perkates ne kete statut.

Te gjitha procedurat per kundershkrimin ndaj zvogelimit te kapitalit, do te ndiqen sipas percaktimeve te ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 14

SHLYERJA E AKSIONEVE

Aksionet per kapitalin me para te nenshkruara ne zbatim te nje vendimi per zmadhimin e kapitalit, do te shlyen te pakten per 50% te vleres se tyre, qe ne momentin e nenshkrimit te tyre. Primet e emisionit te aksioneve, kur do te kete te tille, do te shlyen teresisht ne kohen e nenshkrimit te aksioneve.

Asambleja e Jashtezakonshme qe vendos zmadhimin e kapitalit ka te drejte te marre vendim per shlyerjen teresore te aksioneve qysh ne momentin e nenshkrimit ne rast se kjo eshte e nevojshme.

Kerkimi i fondeve ju njoftohet nenshkrueseve te pakten 20 dite perpara dates se caktuar per cdo derdhje, me leter rekomande dhe me kthim pergjigje, drejtuar cdo titullari te aksioneve.

Ne rast vonese ne derdhjen e shumave te kerkuara shoqeria i dergon aksionarit nje paralajmerim me leter rekomande dhe me kthim pergjigje. Ne rast se brenda 30 ditesh nuk kryhet derdhja e shumave te caktuara atehere do te fillojne te llogariten interesat sipas perqindjeve ligjore, duke filluar nga data e kerkimit te cdo derdhje, pa qene nevoja per te hequr dore nga veprimet e shoqerise ndaj aksionerit detyrues dhe nga masa e zbatimit te detyruar te parashikuar nga ligji.

NENI 15

FORMA E AKSIONEVE

Aksionet jane te formes emerore. Pronesia e aksioneve rezulton nga regjistrimi i tyre ne librin e aksioneve i cili mbahet prane selise qendrore te shoqerise. Aksioneri ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje ekstrakt nga libri i aksioneve, i cili vertetohet me vulen e shoqerise.

Aksioneri ka te drejte, ne cdo kohe, te verifikojte nese emri i tij eshte regjistruar ne librin e aksioneve dhe te verifikojte aksionet qe jane per llogari te tij.

NENI 16

SHITJA DHE TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Aksionet janë të tregtueshme vetëm pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe në rastin e një rritje kapitali pas regjistrimit të këtij ndryshimi.

Aksionet mbeten të tregtueshme pas prishjes së shoqërisë dhe deri në përfundim të procesit të likuidimit.

Aksionet janë lirish të transferueshme ndërmjet aksionereve. Transferimi i pronësive mbi aksionet nominative tek një person i tretë, duhet të miratohet nga Asambleja e Zakonshme e Aksionereve me vendim të aksionereve që zoterojnë shumicën prej 3/4 e kapitalit fillestar, gjithashtu po në rastin e transferimit të pronësive së aksioneve nominative tek një person i tretë jo aksioner, aksionerët e tjerë të shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes dhe duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditësh me marrjen e ofertës për blerjen e aksioneve. Në rast se kjo e drejtë nuk ushtrohet brenda këtij afati ose kur aksionerët heqin dorë prej saj, pronësia mbi aksionet mund t'u transferohet të tretëve me të njëjtat kushte që u është ofruar aksionereve të tjerë.

Për transferimin e aksioneve nga njëri aksioner tek trashëgimtaret e tij duhet të kërkohet paraprakisht miratimi i aksionereve të tjerë të cilët vendosin për transferimin në bazë të shumicës së kapitalit themelitar të mbetur pas heqjes së pjesës së aksionerit, aksionet e të cilit transferohen për shkak të trashëgimisë. Në një rast të tillë në quorumin e votimit nuk llogariten aksionet objekt transferimi dhe as vota e aksionerit subjekt votimi, apo mandatmbajtës të tij.

KREU III

DREJTIMI DHE MENAXHIMI I SHOQËRISE

NENI 17

ORGANET DREJTUESE TE SHOQËRISE

Organet drejtuese të Shoqërisë Aksionere "DIGIT – ALB" Sh.a. janë:

- Asambleja e Aksionereve (e zakonshme, e jashtëzakonshme)
- Këshilli Mbikqyres
- Drejtori i Përgjithshëm

NENI 18

ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

Asambleja e aksionereve eshte organi supreme I shoqerise dhe perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote dhe vendimet e saj merren ne perputhje me ligjin dhe kete statut dhe jane te detyrueshme per te gjitha aksioneret. Asambleja mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme, sipas rendesise se ceshtjeve qe do te shqyrtohen dhe vendosen.

Asambleja e zakonshme apo e jashtezakonshme thirret nga Drejtori i Pergjithshem i shoqerise me ane te nje letre rekomande derguar aksionereve dhe ekspertit kontabel ne adresen qe rezulton ne librin e aksionereve, te pakten 15 dite perpara dates se mbledhjes. Ne leter tregohet vendi, data dhe ora e mbledhjes si dhe rendi i dites. Ne te njejten leter tregohen vendi, data dhe ora e mbledhjes se dyte nese nuk realizohet mbledhja e pare.

NENI 19

LLOJET E ASAMBLESE SE AKSIONEREVE

Asambleja e aksionereve ndahet ne dy lloje:

- Asambleja e Zakonshme
- Asambleja e Jashtezakonshme

NENI 20

ASAMBLEJA E ZAKONSHME

Mbledhja e Asamblese se Zakonshme mbahet ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te percaktuar ne njoftim.

Asambleja e Zakonshme shqyrton dhe vendos per te gjitha ceshtjet qe nuk i perkasin Asamblese se Jashtezakonshme sipas Statutit dhe ligjit, dhe ne vecanti:

- Emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres, Ekspertit Kontabel;
- Percakton shperblimet e anetareve te Keshillit Mbikqyres, Ekspertit Kontabel;
- Aprovon marreveshjet, e paraqitura nga Keshilli Mbikqyres ne perputhje me autorizimin perkates per kete qellim;
- Shqyrton dhe vendos mbi te gjitha ceshtjet financiare te vitit financiar qe ka kaluar;
- Miraton Bilancin, Relacionet e Keshillit Mbikqyres dhe Ekspertit Kontabel;
- Autorizon emetimin e obligacioneve dhe nxjertjen e akteve te vecanta te sigurimit qe lidhen me to;
- Aprovon ndarjen e fitimit, dividendit;

- Aprovon planet e organizimit dhe te zhvillimit te aktivitetit;
- Te tjera ceshtje ne kompetence te saj ne baze te Ligjit ose te tjera, te cilat i nenshtrohen me perpara nje ekzaminimi nga anetaret e Keshillit Mbikqyres.

Asambleja e zakonshme thirret ne mbledhje te pakten cdo 6 muaj. Per procedurat e thirrjes, njoftimeve dhe zhvillimit te mbledhjes se Asambles te Zakonshme zbatohen rregullat e percaktuara ne Ligjin Nr. 7638, date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Aksioneret eventualisht duhet te njoftohen edhe per personat e tjere qe do te thirren dhe per arsyen e thirrjes se tyre ne mbledhjen e Asamblese. Organizatoret e mbledhjes ne njoftim mund te kerkojne nga aksioneret qe brenda nje afati te caktuar te konfirmojne prezencen e tyre ne mbledhje me shkrim, apo me menyra te tjera te provueshme komunikimi.

Per efekt vlefshmerie dergimi i njoftimeve per mbledhjen e Asamblese dhe marrja e tyre ne dorezim nga aksioneret duhet te pasqyrohen ne librat e protokollit te shoqerise ose/dhe te arkivohen te shoqeruar nga mandatat postare perkates.

Aksioneret qe gjenden ne pamundesi per t'u paraqitur ne mbledhjen e Asamblese per te cilen jane njoftuar si me siper, mund te kerkojne nga organizatoret e mbledhjes qe mbledhja e caktuar ne kete date te shtyhet ne nje date tjeter nepermjet nje kerkese me shkrim qe duhet t'i dorezohet organizatoreve apo Drejtorit te Pergjithshem te pakten 5 dite para dates se zhvillimit te mbledhjes.

Cdo aksioner ka te drejte te marre pjese ne Asamble, te beje prezent opinion e tij dhe te perfaqesoje ne votim aq vota sa numri i aksioneve qe zoteron ne kapitalin e shoqerise. Cdo aksioner eshte i barabarte me nje vote. Cdo aksioner ka te drejten e perfaqesimit nga nje perfaqesues me prokure te posacme, i cili mund te marre pjese ne votim.

Per vlefshmerine e vendimeve te Asamblese te Zakonshme, ftohen te marrin pjese ne mbledhje te gjithe aksioneret dhe ne mbledhjen e pare duhet te jene te pranishem aksioneret qe zoterojne te pakten 1/4 e aksioneve. Ne mbledhjen e dyte nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e Zakonshme merr vendime te vlefshme me shumicen e thjeshte (50% +1) te votave te aksionereve te pranishem.

NENI 21

ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME

Asambleja e Jashtezakonshme duhet te thirret kur duhen shqyrtuar ndryshime ne aktin themelues dhe ne statut si dhe te tjera ceshtje te kompetences se saj, ne baze te ligjit. Asambleja e Jashtezakonshme vendos mbi ndryshimet e aktit themelues dhe te statutit, mbi institucionalizmin e filialeve te shoqerise brenda dhe jashte shtetit, mbi rritjen dhe reduktimin e kapitalit te shoqerise dhe filialeve, mbi zgjerimin ose ngushtimin e objektit te aktivitetit, mbi shpalljen dhe shkallen e pjesmarrjeve ne shoqeri te tjera, mbi transferimin e kuotave te kapitalit themeltar, shlyerjen e aksioneve, pushimin e veprimtarise se shoqerise, etj.

Ne mbledhjen e pare Asambleja e Jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme vetem kur aksioneret e pranishem zoterojne te pakten $\frac{1}{2}$ e aksioneve me te drejte vote dhe ne mbledhjen e dyte kur jane te pranishem aksioneret qe zoterojne te pakten $\frac{1}{4}$ e aksioneve me te drejte vote.

Asambleja e Jashtezakonshme merr vendime te vlefshme me nje shumice votash prej $\frac{3}{4}$ qe u perkasin aksionereve te pranishem dhe te perfaqesuar.

NENI 22

KESHILLI MBIKQYRES

PERBERJA E KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 anetare.

Keshilli Mbikqyres zgjedh midis anetareve te tij nje Kryetar, i cili koordinon veprimtarine e Keshillit Mbikqyres dhe ketij te fundit me Asamblene e Aksionereve dhe Drejtorin e Pergjithshem. Ne mungese te kryetarit, drejtimin e Keshillit e merr Zv/Kryetar i Keshillit. Keshilli Mbikqyres gjithashtu mund te emeruje edhe nje sekretar jashte anetareve te tij.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres zgjidhen me vendim te Asamblese se Zakonshme te Aksionereve per nje afat trevjecar dhe me te drejte riemerimi.

Per shkaqe te perligjura, anetaret e Keshillit Mbikqyres shkarkohen ne cdo moment me vendim te Asamblese se Zakonshme te Aksionereve.

Ne rastin e vendeve bosh qe krijohen nga doreheqja ose vdekja e njerit apo disa anetareve te Keshillit Mbikqyres, Drejtori i Pergjithshem therret menjehere mbledhjen e Asamblese se Aksionereve, me rend dite plotesimin e organikes se Keshillit Mbikqyres.

NENI 23

PROCEDURA E MBLEDHJES SE MARRJES SE VENDIMEVE

Keshilli Mbikqyres mblidhet sa here qe eshte e nevojshme sipas interesit te shoqerise.

Keshilli Mbikqyres mblidhet me thirrjen nga Kryetari i tij, ne keto raste:

- Me iniciativen e vet;
- Me propozim me shkrim te nje anetari te Keshillit Mbikqyres;
- Me propozim me shkrim te Drejtorit te Pergjithshem.

Mbledhja duhet thirrur brenda 15 diteve nga momenti i paraqitjes se propozimit.

Cdo mbledhje duhet te tregojë ceshtjet kryesore te rendit te dites. Mbledhja e Keshillit behet ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjetër te percaktuar ne flete thirrjen.

Per vlefshmerine e vendimeve te Keshillit Mbikqyres kerkohen qe te ftohesh ne mbledhje te gjithë anetaret e tij dhe te jene te pranishem mbi 50%.

Keshilli Mbikqyres merr vendime te vlefshme vetem me shumicen e votave te anetareve te pranishem, nje perjashtim te ceshtjeve te meposhtme, per te cilat kerkohet prezenca e te gjithë anetareve te Keshillit Mbikqyres:

- Miratimi i autorizimit per krijimin e filialeve dhe degeve te reja te shoqerise;
- Emerimi i Drejtorit te Pergjithshem te Shoqerise;
- Caktimi i mases se shperblimit per Drejtorin e Pergjithshem.

Keshilli Mbikqyres mban nje regjister te pjesemartjes ne mbledhje, i cili nenshkruhet prej te gjithë antareve te pranishem ne te.

Vendimet e Keshillit Mbikqyres evidencohen ne procesverbale te hartuara ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi dhe nenshkruhen nga kryetari i seances dhe nga anetaret e Keshillit Mbikqyres, ose ne mungese te Kryetarit nga jo me pak se 2 anetare te Keshillit.

Shperblimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres perballohet nga llogaria e shoqerise.

NENI 24

KOMPETENCAT E KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres miraton rregulloren, e cila trajton me hollesi menyren e funksionimit te tij.

Keshilli Mbikqyres vendos per:

- Autorizon Drejtorin e Pergjithshem per kryerjen e veprimtarise se tij menaxhuese ne perputhje me kete statut.
- Miratimi i autorizimit per krijimin e filialeve dhe degeve te reja te shoqerise;
- Emertimi i Drejtorit te Pergjithshem te Shoqerise;
- Caktimi i mases se shperblimit per Drejtorin e Pergjithshem.

Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll ndaj Drejtorit te Pergjithshem per administrimin e shoqerise nga ana e tij.

Keshillit Mbikqyres ka te drejte te kryejë ne cdo kohe verifikime dhe kontrole qe ai i gjykon te nevojshme dhe te kerkoje te njihet me dokumentat qe i nevojiten per realizimin e detyrave.

Keshilli mbikqyres i paraqet Asamblese se Zakonshme ne mbledhjen vjetore, verejtjet e tij mbi raportin e Bordit te Drejtoreve si dhe ato mbi llogarite e vitit financiar.

NENI 25

SHPERBLIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT MBIKQYRES

Kompetente per percaktimin e menyres dhe mases se shperblimit te antareve te Keshillit Mbikqyres eshte Asambleja e Zakonshme.

NENI 26

EMERIMI I ANETAREVE TE PARE TE KESHILLIT MBIKQYRES

Ka te drejte te propozoje per anetaret e Keshillit Mbikqyres cdo aksioner qe perfaqeson te pakten 1/10 e kapitalit themeltar.

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane:

Z. Dritan Hoxha

Z. Petraq Shomo

Z. Arben Taipi

NENI 27

DETYRIMI PER RUAJTJEN E KONFIDENCIALITETIT

Anetaret e Bordit te Drejtoreve dhe te Keshillit Mbikqyres si dhe cdo person qe thirret te marre pjese ne mbledhjet e ketyre organeve duhet te ruaje fshehtesine per te dhenat qe kane karakter te brendshem dhe qe cilesohen si te tilla nga kryetari.

NENI 28

DREJTORI I PERGJITHSHEM I SHOQERISE

Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise emerohet nga Keshilli Mbikqyres, kur per te jane dakort jo me pak se 2/3 e anetareve te ketij Keshilli. Ai ushtron funksionet e tij nen kontrollin e Keshillit Mbikqyres.

Drejtori i Pergjithshem shqyrton dhe merr vendime sipas kushteve te caktuara ne kete statut. Ai raporton per veprimtarine e tij dhe pergjigjet para Keshillit Mbikqyres per realizimin e angazhimeve dhe qellimeve qe jane detyre dhe ne kompetencat e tij.

Drejtori mbron interesat e shoqerise dhe perfaqeson shoqerine perpara te treteve, ne gjykata dhe arbitrazhe, administron pasurine, me perjashtim te kompetencave qe iu takojne organeve te tjera te shoqerise.

Klauzolat e statutit dhe te ligjit qe kufizojne kompetencat e Drejtorit te Pergjithshem duhet te respektohen nga te tretet.

Eshte ne kompetence te Drejtorit te Pergjithshem te marre vendime per:

- Menaxhimin e pergjithshem te veprimtarise se shoqerise;
- Ekzekutimin e vendimeve te Asamblese se Aksionereve dhe te Keshillit Mbikqyres;

Drejtori i Pergjithshem administron vulen e shoqerise.

Ai perfaqeson shoqerine perpara te treteve, autoriteteve gjyqesore, zyres se permbarimit pa patur nevojte per miratim paraprak apo autorizim.

Drejtori i Pergjithshem eshte person fizik dhe emerohet per nje periudhe dyvjecare, me te drejte riemerimi disa here.

Emerimi dhe shkarkimi i tij eshte kompetence vetem e Keshillit Mbikqyres, por gjithmone shkarkimi i tij behet per shkaqe te perligjura.

Kryetari i Keshillit Mbikqyres, ne emer te Shoqerise, lidh kontraten e punes me Drejtorin e emeruar, ku fiksohen kushtet e punes dhe te pageses se ketij te fundit.

KREU IV

KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 29

KONTROLLI I SHOQERISE, EKSPERTI KONTABEL

Ne shoqeri kontrolli ushtrohet nga eksperti kontabel i autorizuar. Eksperti kontabel i autorizuar emerohet nga Asambleja e Zakonshme e Aksionereve per nje periudhe 3 vjecare, me te drejte rizgjedhjeje. Shoqeria ka te drejte te emeroje nje ose disa te tille.

Ne cdo kohe te vitit ekspertet kontabel te autorizuar se bashku ose vec e vec, bejne te gjitha verifikimet dhe kontrollet qe i gjykojne te arsyeshme dhe per kete mund te shfrytezojne ne vend te gjitha dokumentacionin e vleresuar si te dobishem ne ushtimin e funksionit te tyre dhe ne vecanti kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel, regjistrat dhe procesverbalet.

Eksperti kontabel i ben te njohur Drejtorise dhe Keshillit Mbikqyres:

- Kontrollet dhe verifikimet qe ka kryer
- Pjese te bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit, per te cilat ai ka verejtje
- Mangesite, parregullshmerite dhe pasaktesite qe ka konstatuar gjate punes se tij.

Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne mbledhjet e Drejtorise, kur mbyllen llogarite e vitit financiar. Ato mund te thirren dhe ne mbledhjen e Asamblese dhe Keshillit Mbikqyres.

Ekspertet kontabel te autorizuar jane pergjegjes si perpara shoqerise edhe perpara te treteve per pasojat qe rrjedhin per faj ose neglizhence te tyre gjate ushtrimit te detyrave dhe funksionit qe kane.

Shperblimi i eksperteve kontabel te autorizuar i ngarkohen shoqerise dhe masa e tyre caktohet me rastin e emerimit te tyre nga asambleja e aksionereve.

Eksperti i pare kontabel i autorizuar i shoqerise anonime "DIGIT – ALB" eshte Znj.Diana Golemi.

NENI 30

USHTRIMI FINANCIAR

Ushtrimi financiar fillon ne date 1 janar dhe mbaron ne date 31 dhjetor te cdo viti kalendarik.

Perjashtimisht, ushtrimi i pare financiar fillon nga data e rregjistrimit si person juridik te shoqerise dhe mbaron me date 31 dhjetor te atij viti.

NENI 31

INVENTARI, LLOGARITE VJETORE

Shoqeria mban kontabilitet te rregullt ne perputhje me ligjin ne kete fushe.

Ne mbyllje te cdo ushtrimi financiar, Drejtori i Pergjithshem harton inventarin e elementeve te ndryshem te aktivitetit dhe te pasivitetit deri ne ate date si ne llogarite vjetore te shoqerise.

Drejtori i Pergjithshem harton raportin vjetor per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar te mbyllur, ndryshimet e parashikuara per te ardhmen, veprimet e ndodhura prej dates kur eshte hartuar raporti dhe veprimet e kerkimit dhe zhvillimit.



NENI 32

SHKAQET E SHPERNDARJES SE SHOQERISE

Shoqeria shperndahet:

- Me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme
- Kur shoqeria falimenton
- Ne cdo menyre te parashikuar ne ligj

Grumbullimi i te gjitha aksioneve ne nje aksioner, nuk perben shkak per shperndarjen e shoqerise.

NENI 33

LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rastin e shkrirjes shoqeria i nenshtrohet likuidimit. Per likuidimin e shoqerise zbatohen rregullat e percaktuara ne ligjin per shoqerite tregtare.

Asambleja e zakonshme e aksionereve cakton likuidatoret duke percaktuar edhe fuqite qe ato kane.

NENI 34

RAPORTET VJETORE

Ne fund te cdo viti financiar, drejtoria ben inventarin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin, te cilat ja paraqet se bashku me bilancin Keshillit Mbikqyres dhe Asamblese se Aksionereve per shqyrtim.

Nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur, nese ka, humbjet e vitit te meparshem, heq menjane nje shume ne masen mbi 5% te fitimit neto, e cila destinohet per formimin e nje fondi rezerve, te quajtur rezerve e domosdoshme. Cdo vendim i kundert eshte i pavlefshem. Kjo lenie menjane nuk perben detyrim kur rezerva e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Asambleja e zakonshme, ne rast nevojje, mund te formoje fonde te tjera, pervec fondeve te percaktuara ne paragrafin e meparshem te ketij neni.

Pas plotesimit te shumes te fondeve te mesiperme, pjesa e mbetur e fitimit, caktohet per ndarje per aksioneret, ne varesi me perqindjet e pjesemarrjes se tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise ose mund te investohet ne baze te vendimit te Asamblese se Zakonshme te aksionereve.

NENI 35

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Te gjithë mosmarreveshjet që mund të lindin në interpretimin dhe zbatimin e këtij Statuti dhe të aktit të themelimit të shoqërisë si dhe në përgjithësi të gjitha mosmarreveshjet midis ortakëve përveçse ato që i përket shoqërisë, nëqoftëse nuk zgjidhen me mirëkuptim midis palëve do të zgjidhen në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

NENI 36

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Për gjithçka që nuk është paraqitur në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil dhe të legjislativës për shoqëritë tregtare.


NENI 37

Ky Statut u lexua, u firmos dhe u nënshkrua nga aksionerët e shoqërisë "DIGIT – ALB" Sh.a.

AKSIONERET

E SHOQËRISË "DIGIT – ALB" Sh.a.


Dritan Hoxha



Petraq Shomo



Arben Taipi



Enkelejd Joti



Alban Jaho



Eduard Podari

